



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme/Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /
Ministry of Internal Affairs

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION



Njoftim

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) lëshon këtë:

Ftesë për aplikim për mësimin e gjuhës frënge për nëpunësit civil/zyrtarët publik të Republikës së Kosovës:

Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka nënshkruar Memorandumin e partneritetit me Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë (ONF) dhe ka filluar me zbatimin programit të Iniciativës Frankofone Nacionale (IFN) 2023-2026 për forcimin e njohurive në gjuhën frënge të marrëdhënieve ndërkombëtare për zyrtarët e saj. Objektivi është veçanërisht forcimi i kapaciteteve në frëngjisht të nëpunësve civilë/publik dhe diplomatëve përgjegjës për dosjet ndërkombëtare dhe të kërkuara që të njëjtit të përfaqësojnë vendin tonë në takimet ndërkombëtare në frëngjisht, veçanërisht në kuadër të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale ;

Instituti i Kosovës për Administratë Publike/Ministria e Punëve të Brendshme si Koordinator teknik i programit në fjalë dhe Instituti Francez i Kosovës si dhënësi i shërbimeve organizojnë programin për mësimin e gjuhës frënge nga niveli A2 deri në C1 për zyrtarët publik/shërbyesit civil të Administratës publike të Republikës së Kosovës.

Programi përkrahet dhe bashkë-financohet 50% nga Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë (ONF) dhe 50% nga pala kosovare, gjegjësisht Instituti i Kosovës për Administratë Publike/Ministria e Punëve të Brendshme.

Qëllimi i mësimin të gjuhës frënge:

Qëllimi i përgjithshëm i Iniciativës Kombëtare Frankofone 2023-2026 i zhvilluar në planet vjetore të kurseve të mësimin, është që të mundësohet ngritja e kapaciteteve në gjuhën frënge për diplomatët, zyrtarët publik/nëpunësit civil, kuadrot dhe ekspertët në kuadër të administratës publike në Republikën e Kosovës, që merren me çështjet ndërkombëtare në mënyrë që të përdorin gjuhën frënge të marrëdhënieve ndërkombëtare në vendimmarrjen në skenën ndërkombëtare. Prandaj, programi përqendrohet në përf forcimin e kapaciteteve profesionale në frëngjisht së marrëdhënieve ndërkombëtare për zyrtarët publik/shërbyesit civil të Republikës së Kosovës.

Më konkretisht, realizimi i IFN-së ka për qëllim:

1. Në administratën qendrore, të krijohet një mjedis i favorshëm për kuadrot dhe ekspertët e nivelit të lartë dhe profesional që janë pjesë e takimeve ndërkombëtare, që të mund të demonstrojnë një nivel të mjaftueshëm në frëngjisht në kontekstin profesional të tyre. Për këtë qëllim, kurset e trajnimit në diplomacinë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare dhe / ose frëngjishten në fushën e

marrëdhënieve ndërkombëtarë do t'u ofrohen diplomatëve, zyrtarëve të lartë, kuadrove dhe ekspertëve të caktuar të administratës qendrore.

2. Zhvillimi, brenda këtij mjedisi të favorshëm (grupi) ekspertësh të nivelit të lartë, të ekspertëve teknikë dhe profesionistë frankofonë përmes sesioneve të gjuhës për kurse profesionale (p.sh. negociimi ndërkombëtar, shkrimi administrativ, të folurit publik, etj.) dhe teknike në fushat përkatëse të ekspertizave të vlefshme në hapësirën frankofone, konferenca ose seminare për tema me interes ndërkombëtarë.

3. Forcimi i "bashkëpunimeve frankofone" dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërmjet kuadrove nacionale dhe ekspertëve nga vendet e Frankofonisë. Kjo do të inkurajojë organizimin e aktiviteteve rajonale dhe / ose ndërkombëtare.

4. Krijimi i një autoriteti vendimmarrës frankofon, me autoritet të mjaftueshëm për të ndikuar në përdorimin e gjuhës (në takimet ndërkombëtare) ose motivimin për mësimin e gjuhës frënge nga bashkëpunëtorët e tyre . Për këtë qëllim, një numri të zyrtarëve publik/nëpunësve civil mund t'u ofrohen trajnime në gjuhën frënge të marrëdhëniet ndërkombëtare.

Kohëzgjatja:

Mësimi i gjuhës frënge për vitin pasues pritet të filloj në muajin mars 2026. Niveli i kursit do të jetë 90 orë mësimi, ora 45 min për nivelin A2, B1, B2 dhe C1 120. Projekti i vitit 2026 është i paraparë të zgjasë deri në fund të vitit.

Përgjegjësitë dhe detyrat e kandidatëve për mësim të gjuhës Frënge:

- Të jenë të pranishëm në sesionet e kursit për së paku 80% të kohës.
- Të kryejnë detyrat e kursit që dalin nga programi IFN 2023-2026 për zyrtarët e lartë, siç përcaktohet nga IKAP.
- Në rast të ndërprerjes së kursit pa ndonjë arsye të paqëndrueshme të kompensojnë dëmin financiar të paraparë në kontratën e cila do të nënshkruhet nga secili kandidat.

Vlerësimi i kandidatëve:

Me qëllim të marrjes certifikatës për mësimin e gjuhës frënge në nivelin A2 deri C1, të gjithë kandidatët do vlerësohen në bazë të njohurive të fituara gjatë mbajtjes së kursit nga profesorët e gjuhës frënge që do të angazhohen nga Instituti Francez në Prishtinë.

Kriteret/kualifikimet e nevojshme për aplikim në program:

- Të jetë punonjës/shërbyes civil/shërbyes publik të Republikës së Kosovës.
- Të ketë aprovimin me shkrim të eprorit.
- Të ketë njohuri të gjuhës frënge për nivelet përkatëse: A2, B1, B2, C1.

Dokumentet e kërkuara

- Aprovimi i eprorit e skanuar.
- Dëshmi për nivelin e gjuhës frënge që zotëroni.

Afati për aplikim:

Kandidatët e interesuar duhet te dërgojnë kërkesën së bashku me dokumentet (aprovimin e eprorit të skanuar dhe dëshminë mbi nivelin e njohjes së gjuhës frënge) në [e-mail: nita.selca@rks-gov.net](mailto:nita.selca@rks-gov.net) ; avni.hasani@rks-gov.net, jo më vonë se 23.01.2026.

Vërejtje:

Ky aplikacion vlen edhe për zyrtarët te cilët kanë përfunduar një sesion vitet e kaluara dhe kanë genë në pritje të informatës për të vazhduar në sesionet e ardhshme sipas nivelit që posedojnë!